

## **Raport Përfundimtar mbi Takimet me Palët e Interesuara për Hartimin e Buxhetit të Komunës së Kërçovës për vitin 2025**

Në kuadër të angazhimit tonë për një transparencë më të madhe dhe përfshirje aktive të komunitetit në proceset vendimmarrëse, Komuna e Kërçovës organizoi një sërë takimesh me grupe të ndryshme të palëve të interesuara. Qëllimi kryesor ishte mbledhja e sugjerimeve, ideve dhe nevojave tuaja për t'i integruar ato në buxhetin e komunës për vitin 2025. Këto takime u zhvilluan me:

- 1. Komunitetin e biznesit.**
- 2. Shoqatat kulturore.**
- 3. Shoqatat sportive.**
- 4. Nxënësit dhe të rinjtë.**
- 5. Personat me nevoja të veçanta.**
- 6. Përfaqësuesit e shkollave fillore dhe të mesme.**

### **Takimi me Komunitetin e Biznesit (I mbajtur më datë 22.10.2024)**

Komuniteti i biznesit shprehu nevojën për një bashkëpunim më të ngushtë me komunën. Ata kërkuan subvencionim të pagave minimale dhe kontributeve për punonjësit e rinj për një periudhë prej 6 muajsh, si dhe monitorim të kompanive të reja për të siguruar zhvillimin e biznesit. Zgjerimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës në zonën industriale "Ivanidol" ishte një tjetër prioritet, duke theksuar nevojën për rrugë të gjera dhe të mirëmbajtura.

Lufta kundër ekonomisë informale u ngrit si një çështje shqetësuese, me kërkesën për masa konkrete nga ana e komunës dhe inspektorëve komunalë. Përfaqësuesit e biznesit kërkuan lehtësira administrative, duke sugjeruar krijimin e një sporteli ose personi kontakti në komunë për kompanitë, si dhe përshejtimin e procedurave në sektorin e urbanizmit.

Promovimi i turizmit lokal u theksua si një mundësi për zhvillimin ekonomik të qytetit. Ata propozuan hartimin e një plani marketingu për atraksionet turistike lokale dhe organizimin e panairove për artizanët dhe prodhuesit vendas.

### **Kërkesat dhe propozimet e komunitetit të biznesit të parashtruara gjatë takimit:**

- 1. Subvencionim i pagave minimale dhe kontributeve për punësimet e reja në kompani:**
  - Sugjerim që komuna të subvencionojë pagën minimale dhe kontributet për punonjësit për një periudhë prej 6 muajsh, në vend që të subvencionojë vetëm kontributet për 12 muaj.
  - Monitorim i kompanive të reja të subvencionuara për më shumë se 12 muaj, për të parë nëse po zhvillojnë biznesin.

**2. Zgjerimi i infrastrukturës në Zonën Industriale "Ivanidol":**

- Sigurimi që rruga drejt zonës industriale të jetë mjaftueshëm e gjerë për kalimin e kamionëve në të dy drejtimet.

**3. Reduktimi i ekonomisë informale (gri):**

- Kërkesë për uljen e ekonomisë informale që krijon konkurrencë të pandershme ndaj bizneseve që operojnë ligjërisht.

**4. Përmirësimi i strategjisë për operimin e kompanive:**

- Nevoja që kompanitë të mësojnë mënyra më efikase të punës për të shmangur humbjen e punonjësve dhe operimin në ekonominë informale.

**5. Përmirësimi i qasjes së inspektorëve komunalë:**

- Kërkesë që inspektorët të kenë një qasje më të mirë, të ndjekin një strategji veprimi, të japin paralajmërime dhe të kontrollojnë se kush dhe si operon.
- Sugjerim që inspektorët të jenë të pranishëm në takime për të ndërtuar besimin në institucione.

**6. Organizimi i takimeve më të shpeshta midis komunitetit të biznesit dhe komunës:**

- Kërkesë për takime të rregullta për të diskutuar problemet dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre.

**7. Adresimi i çështjeve të qenve endacakë dhe menaxhimit të mbeturinave:**

- Shqetësim për ndikimin negativ në imazhin e qytetit, veçanërisht për vizitorët dhe mërgimtarët.
- Propozim për instalimin e kamerave dhe penalizimin e qytetarëve që shkelin rregulloret.

**8. Mbështetje për grumbullimin dhe ruajtjen e veshjeve të vjetra për Kryqin e Kuq:**

- Kërkesë që komuna të sigurojë një objekt për ruajtjen e veshjeve të vjetra, për të ndihmuar Kryqin e Kuq.

**9. Krijimi i një sporteli, ekipi ose personi kontakti në komunë për kompanitë:**

- Nevoja për një pikë kontakti ku kompanitë mund të drejtohen për projekte të caktuara, për të shmangur konfuzionin dhe vonesat.

**10. Informacion mbi progresin e Planit të Përgjithshëm Urban të Kërçovës:**

- Pyetje mbi ecurinë e planit, duke theksuar se vonesat pengojnë tërheqjen e investimeve të huaja.

**11. Hartimi i pikave turistike për të rritur të ardhurat nga turizmi lokal:**

- Sugjerim për krijimin e një harte me atraksione turistike (p.sh., "Kalaja", "Krushina") për të tërhequr turistë dhe gjeneruar të ardhura.

**12. Organizimi i një panairi lokal për artizanët vendas:**

- Kërkesë për organizimin e një panairi ku artizanët lokalë mund të prezantojnë produktet e tyre, në vend që të vijnë pjesëmarrës nga qytete të tjera.
- Sugjerim që panairi të mbahet në "Kalaja" për shkak të kushteve të përshtatshme.

**13. Sigurimi i një liste me kontaktet e personave përgjegjës në komunë për fusha të ndryshme:**

- Në vend të një sporteli, ofrimi i një liste me kontaktet e sektorëve të ndryshëm (urbanizëm, komunal, etj.) ku kompanitë mund të drejtohen drejtpërdrejt.

**14. Përditësime të rregullta mbi progresin dhe zbatimin e çështjeve të diskutura:**

- Pas disa takimesh, duhet të ketë një listë të asaj që është realizuar dhe çfarë mbetet për t'u bërë, për të shkëmbyer idetë në mënyrë efektive.

**15. Rritja e presionit nga sektori i biznesit mbi komunën për veprim:**

- Komuniteti i biznesit duhet të ushtrojë më shumë presion mbi komunën për të nxitur veprim dhe zgjidhje të problemeve.

**16. Përmirësimi i besimit në institucione:**

- Nevoja për rritjen e besimit në institucionet komunale, duke përfshirë përfaqësues të tyre në takime dhe duke ofruar transparencë në veprime.

**17. Adresimi i vonesave në shërbimet urbane:**

- Shprehje e shqetësimit se vonesat në lëshimin e dokumenteve (p.sh., skica) pengojnë zhvillimin e biznesit dhe tërheqjen e investimeve.

**18. Ndërtimi i një strategjie për promovimin e turizmit lokal:**

- Kërkesë për zhvillimin e një plani marketingu që do të promovojë atraksionet lokale dhe do të ndihmojë në zhvillimin e turizmit.

**19. Përfshirja aktive në zhvillimin e strategjive komunale:**

- Bizneset të ofrojnë strategji dhe ide që mund të integrohen në planet komunale për zhvillim ekonomik.

## **20. Mundësia për aplikim në programe si IPARD, IPA, FITR, Horizon, etj.:**

- Kërkesë që komuna të ndihmojë në përgatitjen e aplikacioneve për këto programe, duke ofruar mbështetje teknike dhe informacion.

### **Takimi me Shoqatat Kulturore (I mbajtur më datë 24.10.2024)**

Shoqatat kulturore propozuan që komuna të marrë iniciativën në organizimin e festave dhe ngjarjeve të rëndësishme kulturore, duke përfshirë shënimin e datave të rëndësishme si Dita e Çlirimit të Kërçovës. Ata sugjeruan një alokim të drejtë të buxhetit kulturor, me dedikimin e një pjese për manifestimet me interes komunal dhe pjesës tjetër për projektet e OJQ-ve.

Procesi i aplikimit dhe monitorimit të projekteve u diskutua gjerësisht, duke theksuar nevojën për aplikime të detyrueshme dhe bazuar në kritere të qarta. Shoqatat kërkuan miratimin e hershëm të programit kulturor për të lejuar një zbatim efektiv që nga fillimi i vitit.

#### **Kërkesat dhe propozimet e parashtruara gjatë takimit me shoqatat kulturore:**

##### **1. Organizimi direkt i ngjarjeve kulturore të rëndësishme nga komuna:**

- Komuna të marrë përsipër organizimin e ngjarjeve të rëndësishme kulturore si Viti i Ri, Bajrami, Pashkët, etj., në vend që t'i lërë vetëm në duart e OJQ-ve.
- Komuna të marrë pjesë aktive në shënimin e datave të rëndësishme si festa e patronazhit të komunës dhe Dita e Çlirimit të Kërçovës më 11 shtator, e cila nuk është shënuar nga komuna në vitet e fundit.

##### **2. Alokimi i buxhetit kulturor:**

- 1/3 e fondeve të buxhetit kulturor të dedikohet për manifestimet me interes komunal dhe 2/3 për projektet e OJQ-ve.
- Përfshirja e datave dhe ngjarjeve specifike në programin kulturor, duke lejuar që shoqatat të aplikojnë për organizimin e tyre.

##### **3. Monitorimi dhe vlerësimi i projekteve:**

- Komisioni për Kulturë të monitorojë zbatimin e projekteve të miratuara nga shoqatat.
- Sigurimi që shoqatat të dorëzojnë raporte dhe të ftojnë komunën në ngjarjet e financuara nga buxheti komunal.

#### **4. Procesi i aplikimit për projekte:**

- Bërja e aplikimit për projekte të detyrueshëm, në vend që të jepen vetëm udhëzime, për të siguruar realizimin e projekteve.
- Rritja e pikëve për shoqatat që marrin pjesë me projekte të propozuara nga komuna.
- Kufizimi i numrit të projekteve që një shoqatë mund të aplikojë (p.sh., një ose dy projekte) për të siguruar shpërndarje të barabartë të fondeve.

#### **5. Miratimi i hershëm i programit kulturor:**

- Miratimi i programit kulturor më herët, mundësisht në nëntor ose dhjetor, në mënyrë që zbatimi të fillojë nga janari, në vend që të miratohet në mes të vitit.

#### **6. Kategorizimi i ngjarjeve dhe financimeve:**

- Zhvillimi i kategorive për alokimin e fondeve në programin kulturor (p.sh., kategoria e parë për ngjarjet komunale).
- Përcaktimi i datave dhe ngjarjeve kyçe që duhet të jenë me interes të përgjithshëm dhe të sigurohet respektimi i tyre.

#### **7. Organizimi i konkurseve bazuar në kriterë:**

- Organizimi i konkurseve bazuar në kriterë të qarta, ku shoqatat mund të konkurrojnë me ide konkrete për projekte kulturore.

#### **8. Përfshirja e projekteve që promovojnë tolerancën etnike dhe trashëgiminë kulturore:**

- Përfshirja e projekteve që promovojnë tolerancën etnike dhe evidentojnë trashëgiminë kulturore të komunitetit.

#### **9. Shënimi i ditëve dhe personaliteteve të veçanta:**

- Shënimi i ditëve të veçanta, duke përfshirë një Ditë për Mërgimtarët, për të nderuar kontributin e tyre në komunë.
- Konsiderimi i shënimit të ditëve ndërkombëtare relevante për kulturën.

#### **10. Takime shtesë për zhvillimin e programit:**

- Organizimi i takimeve shtesë për të diskutuar dhe zhvilluar programin kulturor bazuar në diskutimet dhe propozimet.

#### **11. Roli aktiv i komunës në zhvillimin kulturor:**

- Komuna të tregojë se kujdeset për ngjarjet kulturore dhe të marrë pjesë aktive në organizimin ose mbështetjen e tyre.

#### **12. Ndryshimi i konceptit të punës në kulturë:**

- Nevoja për të ndryshuar konceptin e punës, pasi kultura dhe sporti shpesh janë nënvlerësuar.
- Kultura të konsiderohet si faktor i rëndësishëm për zhvillimin e ekonomisë lokale.

#### **13. Shmangia e monopolizimit të fondeve nga një shoqatë:**

- Komisioni të jetë i kujdesshëm që një shoqatë të mos marrë të gjitha fondet, duke siguruar shpërndarje të drejtë për të gjitha shoqatat.

#### **14. Përgatitja e programit bazuar në diskutimet aktuale:**

- Përdorimi i ideve të parashtruara gjatë takimit për të hartuar programin kulturor.

#### **15. Përcaktimi i datave specifike për ngjarjet kulturore:**

- Përcaktimi fillimisht i 3-4 ngjarjeve (datave), të cilat do të shqyrtohen nga Kryetari i Komunës dhe më pas do të dërgohen në këshill për miratim.

#### **16. Përfshirja e shoqatave në përgatitjen e programit:**

- Shoqatat kulturore të jenë të përfshira në procesin e hartimit të programit për të siguruar që nevojat dhe propozimet e tyre të merren parasysh.

### **Takimi me Shoqatat Sportive (I mbajtur më datë 28.10.2024)**

Përfaqësuesit e shoqatave sportive shprehën nevojën për rritjen e buxhetit për sportin, duke marrë parasysh nevojat specifike të klubeve lokale. Ata sugjeruan gjetjen e mënyrave alternative të financimit, përfshirë sponsorizimet nga kompanitë lokale. Mbështetja për kategoritë e reja u pa si jetike për zhvillimin e sportit në qytet, me kërkesën për krijimin e një linje të veçantë buxhetore për ta.

Infrastruktura sportive ishte një tjetër çështje e rëndësishme, me kërkesën për rinovimin e sallave sportive, sigurimin e ndriçimit adekuat dhe pajisjeve të nevojshme. Përfaqësuesit theksuan rëndësinë e organizimit të ngjarjeve sportive lokale dhe promovimin e sportit në komunitet për të inkurajuar pjesëmarrjen e të rinjve.

#### **Kërkesat dhe propozimet e shoqatave sportive të parashtruara gjatë takimit:**

- 1. Rritja e buxhetit për sportin në komunë, pasi aktualisht është shumë i vogël në krahasim me komunat e tjera.**
- 2. Gjetja e zgjidhjeve për shtimin e financimeve në sport, duke propozuar:**

- Rritjen e çmimit të ujit me 2 euro për familje përmes "Komunalec", dhe këto fonde të dedikohen për subjektet sportive.
  - Sigurimin e fondeve përmes sponsorizimeve nga kompanitë lokale.
- 3. Mbështetje për organizimin e turneve sportive:**
- Klubi i volejbollit planifikon të organizojë turne, siç bëri në vitin 2017, dhe ka nevojë për mbështetje shtesë nga komuna.
- 4. Krijimi i një buxheti shtesë specifik për sportin për të financuar aktivitetet sportive.**
- 5. Organizimi i takimeve më të shpeshta midis shoqatave sportive dhe komunës, me mundësinë e formimit të një shoqate ose forumi për zhvillimin e ideve.**
- 6. Fokusimi në zhvillimin e kategorive të reja:**
- Alokimi i një linje të veçantë buxhetore për kategoritë rinore në klubet sportive.
  - Rritja e investimeve në atletët e rinj për të parandaluar largimin e tyre drejt qyteteve të tjera.
- 7. Gjetja e mënyrave të përbashkëta të financimit, duke përfshirë kontaktimin e Agjencisë për Rini dhe Sport për rritjen e buxhetit në të ardhmen.**
- 8. Adresimi i çështjes së ndriçimit të pamjaftueshëm në sallat sportive:**
- Salla sportive "Hristo Uzunov" ka nevojë për ndriçim më të mirë për të përmbushur kriteret e ligës së parë.
  - Nevoja për një sistem të ri ndriçimi në këtë sallë.
- 9. Zgjidhja e problemit të kostove të pastrimit dhe mirëmbajtjes:**
- Klubet aktualisht paguajnë për pastrimin e sallave dhe dhomave të zhveshjes; kërkohet që komuna të marrë përsipër këto shpenzime.
- 10. Sigurimi që objektet sportive të mirëmbahen dhe të mos vandalizohen:**
- Apel për klubet sportive që të kujdesen për sallat dhe të mos i dëmtojnë ato.
- 11. Vendosja e kriterëve për përdorimin e sallave sportive:**
- Trajnerët të nënshkruajnë dokumente nga komuna, duke marrë përgjegjësi për çdo dëmtim të mundshëm.
- 12. Sigurimi i një hapësire të dedikuar për stërvitjen e arteve marciale:**
- Kërkesë që komuna të ofrojë një dhomë për stërvitjen e sporteve luftarake, pasi aktualisht ata duhet të paguajnë shtesë për këtë.

**13. Rinovimi i pistave atletike në "Krushina":**

- Komuna po punon drejt rinovimit të pistave atletike në këtë zonë.

**14. Diskutimi i mundësive për takime me kompanitë në qytet për të diskutuar rritjen e buxhetit për sportin përmes sponsorizimeve.**

**15. Vazhdimi i organizimit të maratonës nga komuna, e cila është vlerësuar si e suksesshme dhe do të vazhdojë në të ardhmen.**

**16. Mbështetja e sportistëve të shquar dhe promovimi i sporteve individuale.**

**17. Shqyrtimi i mënyrave alternative për financimin e projekteve sportive, pasi vetëm dy nga shtatë projektet e propozuara në qeveri janë pranuar.**

**18. Përcaktimi i kriterëve të reja për përdorimin e sallës "Jançica" pas përfundimit të rinovimit.**

**19. Rritja e interesit të komunës në sportet si atletika dhe bashkëpunimi me klubet sportive për organizimin e ngjarjeve.**

**20. Inkurajimi i bashkëpunimit midis klubeve sportive dhe komunës për të zhvilluar strategji efektive për financimin dhe promovimin e sportit në Kërçovë.**

**Takimi me Nxënësit dhe të Rinjtë (I mbajtur më datë 30.10.2024)**

Në takimin me nxënësit, të rinjtë shprehën nevojat dhe dëshirat e tyre për përmirësimin e kushteve në qytet dhe në institucionet arsimore. Ata theksuan rëndësinë e përmirësimit të infrastrukturës shkollore, duke kërkuar rinovimin e laboratorëve të kimisë, fizikës dhe biologjisë, si dhe furnizimin me inventar të ri shkollor. Përmirësimi i kushteve sanitare në shkolla ishte një tjetër shqetësim i tyre.

Të rinjtë propozuan gjithashtu hapjen e një kinoteatri në "Koço Racin" dhe shfrytëzimin e "Kalasë" për organizimin e turneve sportive gjatë verës. Ata shprehën dëshirën për më shumë hapësira ku mund të promovojnë talentet e tyre letrare dhe artistike. Ndërtimi i shtigjeve për biçikleta dhe organizimi i transportit publik drejt zonave rurale ishin ndër propozimet për përmirësimin e infrastrukturës urbane.

Trajtimi i problemit të qenve endacakë dhe përmirësimi i higjienës komunale, duke promovuar riciklimin, ishin shqetësime të tjera të ngritura nga të rinjtë. Ata theksuan rëndësinë e mbështetjes për personat me nevoja të veçanta dhe kërkuan hapjen e një fakulteti në qytet me drejtime specifike, për të rinjtë që nuk kanë mundësi të studiojnë jashtë Kërçovës.



### **Kërkesat e nxënësve/rinjve të parashtruara gjatë takimit:**

1. Përdorimi i buxhetit për përfundimin e spitalit të ri në qytet ose për përmirësimin e kushteve në shkolla.
2. Trajtimi i qenve endacakë, ndërtimi i një strehimoreje për ta dhe kujdesi për personat me nevoja të veçanta.
3. Rinovimi i sanitarisë në shkollën "Drita".
4. Ndërtimi i shtigjeve për biçikleta dhe organizimi i transportit publik drejt zonave rurale.
5. Mundësi më të mëdha në fushën e kulturës, duke lejuar promovimin e aktiviteteve si performanca letrare.
6. Hapja e një kinoteatri në "Koço Racin" dhe shfaqja e filmave të ndryshëm, përfshirë dokumentarë.
7. Shfrytëzimi i "Kale"-s gjatë verës për organizimin e turneve të vogla sportive, për të inkurajuar socializimin e të rinjve.
8. Pasurimi i fondit të bibliotekës me libra për drejtimet profesionale.
9. Rinovimi i inventarit në gjimnaz.
10. Plan për rinovimin e konviktit në gjimnaz.
11. Përmirësimi i higjienës komunale dhe promovimi i riciklimit të mbeturinave në qytet.
12. Përgatitja e një strategjie lokale për të rinjtë dhe hapja e një zyre rinore për komunikim dhe këshillim.
13. Hartimi i një programi ekologjik (EKO program).
14. Stimulimi i praktikës profesionale me pagesë për nxënësit, si motivim për ta.
15. Pajisja e laboratorit të kimisë për të mundësuar krijimin e produkteve që mund të shiten, duke mësuar nga përvojat e vendeve të tjera.
16. Mundësimi i praktikës profesionale në kompani për nxënësit e drejtimit ekonomik.
17. Instalimi i programeve kontabël në kompjuterët e shkollës për praktikë, nëse nuk është e mundur praktikimi në kompani.
18. Hapja e një fakulteti në qytet me drejtime specifike, për t'u mundësuar studimet atyre që nuk kanë mundësi të studiojnë jashtë qytetit.
19. Trajnime shtesë për të rinjtë në kujdesin e personave të sëmurë, marrja e licencave dhe punësimi i tyre.

20. Marrja e masave për uljen e papunësisë dhe mbështetja e vetëpunësimit të të rinjve.

21. Përfshirja më aktive e të rinjve në vendimmarrje dhe inkurajimi i tyre për të dhënë ide dhe iniciativa.

### **Takimi me Personat me Nevoja të Veçanta (I mbajtur më datë 01.11.2024)**

Personat me nevoja të veçanta dhe përfaqësuesit e tyre shprehën nevojat për përmirësimin e infrastrukturës së qytetit, duke kërkuar adaptimin e rampave dhe trotuareve për lehtësimin e lëvizjes, shtimin e vendparkimeve të dedikuara dhe falas, si dhe instalimin e semaforëve me sinjalizim zanor.

Ata kërkuan sigurimin e një zyre për shoqatat e tyre dhe krijimin e dhomave sensoriale në shkolla dhe qendra. Mbështetja sociale dhe kulturore ishte një tjetër kërkesë, me organizimin e kampeve verore dhe ekskursioneve për fëmijët me nevoja të veçanta. Përfaqësuesit theksuan nevojën për inkurajimin e bizneseve për të punësuar persona me nevoja të veçanta dhe lëshimin e kartelave identifikuese për ta.

#### **Kërkesat dhe propozimet e personave me nevoja të veçanta të parashtruara gjatë takimit:**

##### **1. Përfshirja dhe Mbështetja në Aktivitetet Sportive:**

- **Përfshirja në ndihmën komunale për rininë dhe sportin:**
  - Personat me nevoja të veçanta kërkojnë që të jenë të përfshirë në programet dhe fondet që komuna alokon për rininë dhe sportin, pasi edhe ata kanë të rinj që marrin pjesë në aktivitete sportive.
- **Mbështetje për organizimin e aktiviteteve sportive:**
  - Kërkohet mbështetje financiare dhe logjistike për organizimin e aktiviteteve sportive për personat me nevoja të veçanta, duke përfshirë:
    - Përdorimin e sallave sportive pa pagesë ose me kosto të ulët.
    - Organizimin e turneve dhe garave sportive specifike për ta.
    - Sigurimin e pajisjeve sportive të përshtatshme.

##### **2. Përmirësimi i Infrastrukturës së Qytetit:**

- **Rritja e numrit të vendeve të parkimit për personat me aftësi të kufizuara:**
  - Kërkohet që të shtohen vendparkime të dedikuara për personat me nevoja të veçanta dhe ato të jenë të liruara nga pagesa.

- **Përmirësimi i rampave dhe trotuareve:**
  - Adaptimi i rampave ekzistuese që aktualisht janë të larta, të ngushta dhe jofunksionale.
  - Riparimi i trotuareve për të mundësuar lëvizjen e lehtë të personave me aftësi të kufizuara.
- **Instalimi i semaforëve me sinjalizim zanor:**
  - Për të ndihmuar personat me shikim të dëmtuar në kalimin e rrugëve.

### **3. Sigurimi i Hapësirave të Përshtatshme:**

- **Ofrimi i një hapësire për shoqatat:**
  - Kërkohet që komuna të sigurojë një zyrë ose hapësirë ku shoqatat e personave me nevoja të veçanta mund të zhvillojnë aktivitetet e tyre, pasi aktualisht nuk kanë mundësi të paguajnë qira.

### **4. Mbështetje për Aktivitetet Kulturore dhe Sociale:**

- **Shfrytëzimi i hapësirave në "Koço Racin":**
  - Organizimi i projeksioneve filmike, seksioneve artistike dhe aktiviteteve të tjera kulturore për fëmijët me nevoja të veçanta, pa pagesë.
- **Financimi i kampeve verore dhe ekskursioneve:**
  - Komuna të financojë kampe verore për fëmijët me nevoja të veçanta për të rritur përfshirjen sociale.
  - Organizimi i ekskursioneve mujore, duke siguruar transportin për ta.
- **Organizimi i ngjarjeve sportive dhe sociale:**
  - Shënimi i datave të rëndësishme si Dita e Personave me Aftësi të Kufizuara (03.11) me aktivitete të veçanta.
  - Shtimi i ekskursioneve dhe ngjarjeve sportive për personat me nevoja të veçanta.

### **5. Përmirësimi i Shërbimeve dhe Mbështetje Profesionale:**

- **Punësimi i logopedëve dhe defektologëve:**
  - Rritja e numrit të specialistëve në shkolla dhe institucione të tjera për të ofruar mbështetje profesionale për fëmijët me nevoja të veçanta.

- **Përfshirja e psikologëve:**

- Sigurimi i mbështetjes psikologjike për prindërit dhe fëmijët, duke i ndihmuar ata në menaxhimin e sfidave të përditshme.

## **6. Promovimi i Punësimit të Personave me Nevoja të Veçanta:**

- **Nxitja e punësimit në sektorin privat:**

- Inkurajimi i bizneseve lokale për të punësuar persona me nevoja të veçanta, duke krijuar mundësi të barabarta për integrim në tregun e punës.

- **Lëshimi i kartelave speciale për personat me nevoja të veçanta:**

- Pajisja me kartela identifikuese për të lehtësuar njohjen dhe ofrimin e shërbimeve të përshtatshme.

## **7. Lehtësira Financiare dhe Taksat:**

- **Përfshirja nga pagesa e taksës për ndriçimin rrugor:**

- Kërkohej që personat me nevoja të veçanta të jenë të përjashtuar nga pagesa e taksës për ndriçimin rrugor në faturat e energjisë elektrike, siç aplikohet në qytete të tjera.

## **8. Mbështetje në Aplikimin për Projekte:**

- **Asistencë në përgatitjen e projekteve:**

- Komuna të ofrojë ndihmë pa pagesë në aplikimin dhe hartimin e projekteve për financim, duke eliminuar kostot shtesë për shoqatat.

## **9. Riorganizimi i Shoqatave:**

- **Strukturimi sipas moshës dhe nevojave specifike:**

- Riorganizimi i shoqatave për të adresuar në mënyrë më efektive nevojat e fëmijëve parashkollorë, shkollorë dhe grupmoshave të tjera.

## **10. Rritja e Ndërgjegjësimit dhe Përfshirjes:**

- **Organizimi i takimeve me prindërit, shoqatat dhe qendrën ditore:**

- Për të identifikuar nevojat specifike dhe për të përmirësuar shërbimet dhe mbështetjen e ofruar.

- **Fushata për rritjen e ndërgjegjësimit:**

- Inkurajimi i prindërve për të qenë më aktivë dhe për të mos u ndjerë të stigmatizuar, duke promovuar përfshirjen sociale të fëmijëve me nevoja të veçanta.

## **11. Përmirësimi i Infrastrukturës në Qendrat Arsimore:**

- **Krijimi i dhomave sensoriale:**

- Pajisja e shkollave me dhoma sensoriale për fëmijët me nevoja të veçanta, duke ndjekur shembullin pozitiv nga Gostivari.

## **12. Mbështetje për Ditën Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara:**

- **Financimi dhe organizimi i aktiviteteve për datën 3 dhjetor:**

- Komuna të sigurojë fonde dhe hapësira për të shënuar në mënyrë dinjitoze këtë ditë të rëndësishme.

## **Takimi me Përfaqësuesit e Shkollave (I mbajtur më datë 04.11.2024)**

Drejtorët dhe përfaqësuesit e shkollave fillore dhe të mesme shprehën nevojat e tyre për përmirësimin e infrastrukturës shkollore. Ata kërkuan pajisjen e kabineteve me pajisje laboratorike dhe didaktike, rinovimin e çatave, fasadave dhe ulluqeve të shkollave, si dhe shtrimin e oborreve shkollore me pllaka bekatoni. Furnizimi me banka dhe karrige të reja ishte një tjetër kërkesë e tyre.

Ndërtimi dhe rinovimi i sallave të sportit ishte një shqetësim i përbashkët, me kërkesën për përfundimin e projekteve të nisura dhe pajisjen e sallave me mjetet e nevojshme sportive. Përfaqësuesit e shkollave kërkuan ndihmë në zgjidhjen e problemeve financiare, duke përfshirë shlyerjen e borxheve dhe zhblokimin e llogarive bankare. Ata theksuan rëndësinë e rrethimit të shkollave për sigurinë e nxënësve dhe zhvendosjen e kontejnerëve të mbeturinave larg ambienteve shkollore.

### **Kërkesat e përfaqësuesve të shkollave të parashtruara gjatë takimit:**

#### **Shkolla e Mesme "Mirko Mileski":**

1. **Pajisja e kabineteve** për fizikë, kimi, matematikë, elektro, etj.
2. **Sigurimi i pajisjeve sportive** për sallën e rinovuar të sportit.
3. **Furnizimi me banka dhe karrige** për ndërtesën e gjimnazit.
4. **Shtrimi i hyrjes së konviktit** me pllaka, për shkak të problemeve gjatë dimrit.
5. **Marrja e masave për ndotjen** në oborrin e konviktit.

#### **Shkolla e Mesme "Drita":**

1. **Furnizimi me 200 banka dhe 400 karrige** për "Drita", po ashtu edhe për "Mirko Mileski".
2. **Përmirësimi i sanitarisë** në konvikt, pasi aktualisht është në gjendje të keqe.
3. **Rrethimi i oborrit të konviktit.**
4. **Relokimi i kontejnerëve të mbeturinave** në bashkëpunim me "Komunalec".
5. **Vendosja e një rampe** për kontrollin e parkimit pranë konviktit, për të shmangur bllokimet.
6. **Ndihmë për shlyerjen e borxheve dhe zhblokimin e llogarisë bankare** të shkollës.
7. **Sigurimi i inventarit shkollor** të nevojshëm.

#### **Shkolla Fillore "Rexhë Rushit Zajazi":**

1. **Rekonstrukcioni i fasadës** së ndërtesës qendrore shkollore në Zajaz.
2. **Rinovimi i dritareve dhe dyerve** të shkollës.
3. **Furnizimi me banka shkollore të reja**, pasi ekzistueset janë 15 vjet të vjetra.
4. **Shtrimi me pllaka bektoni** i oborrit përpara sallës së sportit, për të zgjidhur problemet gjatë dimrit.
5. **Përsheptimi i procedurave dokumentare** për sallën e sportit, që nxënësit të mund ta përdorin atë.

#### **Shkolla Fillore "Milto Gura":**

1. **Rregullimi i parkimit** përpara shkollës me pllaka bektoni ose asfalt (sipërfaqe prej 1000 m<sup>2</sup>), për të shmangur ndotjen gjatë reshjeve.

#### **Shkolla Fillore "Kuzman Josifovski Pitu":**

1. **Informacion mbi progresin e ndërtimit të sallës së sportit** në shkollë.
2. **Rinovimi i ulluqeve të çatisë** së ndërtesës shkollore.
3. **Rregullimi i parkimit** në pjesën pranë shkollës së vjetër.

#### **Kopshti i Fëmijëve "Olga Miceska":**

1. **Ndihmë financiare për riparimin e çatisë** në kopshtin "Cvetovi" (vlera e projektit: 3 milion denarë).
2. **Zgjidhja e çështjeve të ngrohjes** në objektin "Dolno", pasi ka probleme me furnizimin me dru për ngrohje.

#### **Shkolla Filllore "Hristo Uzunov":**

1. **Ndihmë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe përfundimin e rrethimit të shkollës.**
2. **Riparimi i çatisë për të parandaluar rrjedhjet gjatë reshjeve.**
3. **Zëvendësimi i dritareve në sallën e sportit.**
4. **Ndihmë për marrjen e pranimit teknik të shkollës, për të aplikuar në projekte ndërkombëtare.**

#### **Shkolla Filllore "Gjergj Kastrioti Skënderbeu":**

1. **Vendosja e portës hyrëse dhe rrethimi i objektit shkollor në Zhubrino.**
2. **Ndërtimi i sanitarisë në oborr në Srbicë, për ndërtesën e re që mungon.**

#### **Universiteti i Punëtorëve "Krste Misirkov":**

1. **Zgjidhja e problemit të parkimit (vendosja e rampës së re).**
2. **Rrethimi i oborrit, pasi gardhi ekzistues është dëmtuar.**
3. **Shtimi i numrit të punonjësve për të formuar komisionin e prokurimeve publike.**
4. **Pajisja e sallës për t'u përdorur për trajnime në vallëzim ose balet.**

#### **Shkolla Filllore "Faik Konica":**

1. **Pajisja e kabineteve për biologji, kimi dhe fizikë.**
2. **Krijimi i një hapësire për prindërit brenda shkollës.**
3. **Ndërtimi i tualeteve të veçanta për stafin, pasi aktualisht ndahen me nxënësit.**
4. **Rinovimi i murit mbajtës, i cili mund të shembet pas disa vitesh.**
5. **Rregullimi i oborrit shkollor në Kolibarë.**
6. **Rregullimi i fushave sportive në Baçishtë.**

#### **Shkolla Filllore "Vladimir Polezinoski":**

1. **Rinovimi i dyshemesë në katin e parë.**
2. **Lidhja e ngrohjes në sallën e sportit.**
3. **Ndihmë për pagesën e shpërblimeve jubilarë dhe pensioneve, nevojiten 720 mijë denarë.**
4. **Rikthimi i buxhetit të mëparshëm nga viti 2024, pasi është shkurtuar me 45%.**

## **Përfundim**

Të gjitha këto takime kanë qenë shumë produktive dhe kanë ofruar një pasqyrë të qartë të nevojave dhe pritshmërive tuaja. Komuna e Kërçovës është e angazhuar të marrë parasysh çdo kërkesë dhe propozim, duke i integruar ato në buxhetin e vitit 2025 në përputhje me mundësitë financiare dhe prioritetet strategjike.

Ne besojmë se përfshirja aktive e qytetarëve në proceset vendimmarrëse është thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm të komunës sonë. Ju falënderojmë për kontributin tuaj dhe ju inkurajojmë të vazhdoni të jepni sugjerimet dhe idetë tuaja për përmirësimin e jetës në Kërçovë.

Me respekt,

**Komuna e Kërçovës**